

**STATUT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Real Estate Group”**

Ne baze e ne zbatim te ligjit

- Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” me poshte referohet si “Ligi Per Shoqerite”,
- Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit”;
- Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;

veprimitaria e shoqerise

“Real Estate Group” sh.p.k.

do te organizohet dhe do te drejtohet sipas ketij Statuti te trajtuar ne te njejten dokument me Aktin e Themelimit.

**PJESA E PARE
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1
Ortaket**

1.1 Ortaket e shoqerise jane :

1. **Erjon Disani** , i biri i Izet , shtetas Shqiptar , lindur me 14 Korrik 1991 ne Neshte,Librazhd ,banues ne Tirane, Shqiperi , mbajtes i kartes me nr personal J10714034Q , madhor dhe me zotesi juridike te plete per te vepruar.
2. **Biljana Malevski** , e bija e Ilo , shtetas Shqiptar , lindur me 07 Gusht 1993 ne Korce ,banues ne Tirane, Shqiperi , mbajtes i kartes me nr personal J35807070P , madhor dhe me zotesi juridike te plete per te vepruar.
3. **Lidjora Rrapo** , e bija e Dhiogjen , shtetas Shqiptar , lindur me 10 Korrik 1987 ne Erseke, Kolonje ,banues ne Tirane, Shqiperi , mbajtes i kartes me nr personal I75710041R , madhor dhe me zotesi juridike te plete per te vepruar.

**Neni 2
Emri**

Emri i shoqërisë është **Real Estate Group sh.p.k.**, (më poshtë referuar si “Shoqëria ”).



Neni 3
Selia e Shoqerise

- 3.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: "Tirane, Zona kadastrale 8270, Rruga Medar Shtylla, pasuria nr 6/110+1-6, prane Rrethrotullimit, Komuna e Parisit, Tirane.
- 3.2 Shoqeria mund te hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikes se Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 4
Forma ligjore

- 4.1. Shoqeria është shoqeri shqiptare dhe është krijuar si **shoqeri me përgjegjësi të kufizuar**.

Neni 5
Kohëzgjatja

- 5.1. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar per nje periudhe te pacaktuar (pakufizuar).

Neni 6
Objekti i aktivitetit

Objekti i veprimtarise se shoqerise "Real Estate Group"sh.p.k, konsiston ne:

1. Agjensi imobiliare,
2. Zgjerim rrjeti Franchising
3. Dhenie Licence per ushtimin e aktivitetit franshize
4. Studime tregu per pasuri te paluajtshme,
5. Komisioner dhe agjensi per te tretet.
6. Trajnim dhe konsulence ne trajtimin dhe shitjen e pasurive te paluajtshme
7. Konsulence per shitje dhe blerje, qiramarje dhe qiradhenie,
8. Dhe cdo sherbim tjeter ne lidhje me tregun imobiliar ne te gjithe nivelet e sherbimit.

- 6.1. Shoqeria mund te kryeje edhe aktivitete te tjera shtese, me qellim permbushjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

PJESA II
KAPITALI I SHOQËRISE DHE KUOTAT

Neni 7
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali i shoqerise eshte 300,000 (treqind mijë) Leke i marre persiper dhe i nenshkruar nga ortaket.



Kapitali themeltar eshte i ndare ne 3 (tre) kuota e cila zoterojen nga ortaket si me poshte :

Ortaku	Kuotat e Nenshkruara	Vlera ne Leke	Perqindja(%)
Erjon Disani	1	102,000	34%
Biljana Malevski	1	99,000	33%
Lidjora Rrapo	1	99,000	33%
Total	1	300,000	100%

Kapitali themeltar eshte vetem ne monedhen vendase, lek.

III. STRUKTURA DREJTUESE TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 8 Përgjegjësia e kufizuar

8.1. Ortaket jane përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

Neni 9 Të drejtat e lidhura me cdo kuotë

9.1. Cdo kuote e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korrensponduese në mbledhjet e ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën përmarrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

Neni 10 Fitimi dhe kalimi i kuotave

- 10.1. Kuotat e kapitalit te shoqerise fitohen apo kalohen nepermjet:
 - a. kontibutin ne kapitalin e shoqerise;
 - b. shitblerjes;
 - c. trashegimise
 - d. dhurimit
 - e. cdo menyre tjeter parashikuar me ligj.
- 10.2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata do behet me shkrim.

Neni 11 Detyrimet e Ortakëve

11.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e



veprimeve të saj si dhe të përbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

PJESA IV

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 12

Të drejtat e asamblesë së pergjithshme

- 12.1 Asambleja e pergjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha cështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Asambleja e pergjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.
- 12.3 Vetëm asambleja e pergjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
 - (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
 - (b) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
 - (c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencioni të dhënë nga ortakët;
 - (d) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
 - (e) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
 - (f) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
 - (g) pjesetimin dhe anullimin e kuotave;
 - (h) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - (i) miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të shoqërise si dhe shpërndarjen e fitimit;
 - (j) blerjen, shitjen dhe chënien peng të pasurive të paluajtshme;
 - (k) marrjen me qira, dhënen me qira ose dhënen e cdo të drejtë për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
 - (l) të vendosë për investimet;
 - (m) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
 - (n) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
 - (o) të caktøjë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
 - (p) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagesë mbi largimin e drejtoreve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
 - (q) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
 - (r) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
 - (s) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - (t) percaktimin e shperblimeve per likujduesit, ekspertet kontabel;
 - (u) mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët;
 - (v) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjes se asamblese;
 - (w) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;



- (x) përcaktimin e buxhetit vjetor;
 - (y) miratimin e cdo cështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së pergjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.
 - (z) Marrjen e huave ne emer te shoqerise dhe vendosjen e kushteve te huase
 - (aa) Lidhjen e mareveshjeve per dhenien e huave
- 12.4 Asambleja e pergjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi cdo cështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

Neni 13 **Vendimet e asamblesë së pergjithshme**

- 13.1 Vendimet e renditura përsa i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Neni 14 **Thirrja e asamblesë së pergjithshme**

- 14.1 Asambleja e pergjithshme do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose ne cdo vend tjeter nëse percaktohet ne njoftim.
- 14.2 Gjithashtu, ortakët të cilet perfaqësojnë të paktën 20 për qind të totalit të votave ne asamblenë e pergjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e pergjithshme. Në kërkesën drejtuar administratorëve mund të përfshihen dhe cështjet e posacme të rendit të ditës.
- 14.3 Asambleja e pergjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, email , telexi apo faksi jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpëra datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.
- 14.4 Njoftimi për takimin e asamblesë së pergjithshme do të tregojë datën kohën dhe vedin e takimit si dhe cështjet e rendit të ditës.
- 14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- 14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

Neni 15
Vendimet e marra në asamblenë e per gjithshme

- 15.1 Vendimet në asamblenë e per gjithshme të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 % të kuotave. Vendimet në asamblesë e përgjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merrën vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zoterojnë më shumë së gjysmën e numrit total të votave.
- 15.2 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 15.3 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblese, të cilat do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.4 Nëse mbledhja e asamblese se per gjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

Neni 16
Drejtimi i mbledhjes se asamblese se per gjithshme

- 16.1 Kryetari i mbledhjes së asamblese se per gjithshme do të caktohet nga ortakët.
- 16.2 Do të aprovojen apo refuzohen vetëm ato cështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi cështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japid pëlqimin e tyre.

Neni 17
Procesverbal i mbledhjes së asamblese se per gjithshme

- 17.1 Për cdo mbledhje të asamblese se per gjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Prosesverbal duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregtar dhe një për secilin ortak. Prosesverbalit i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.2 Prosesverbalit do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve.



Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.

- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesvebalit dhe shpëmendarjen e tij.

PJESA V ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 18 Administrimi i Shoqërisë

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose me shume administratore, te cilet do te përfaqësojnë Shoqërinë. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.
- 18.2 Administratorët mund të autorizojnë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të vecanta.
- 18.3 Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha cështjet që kanë lidhje me të.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 18.5 Administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:
- (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
 - (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
 - (c) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
 - (d) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
 - (e) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënen dhe marrien e paradhënieve;
 - (f) dhënen e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënieve të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
 - (g) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
 - (h) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i térheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të myllin marrëveshje



- arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të térheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet;
- (i) administratorët kanë të drejtë marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
 - (j) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
 - (k) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
 - (l) administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
 - (m) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
 - (n) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
 - (o) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
 - (p) marrin vendime mbi të gjitha cështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë che marrëdhëniet e saj të jashtme.

18.6 Personi i mëposhtëm do të caktohet administrator për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë ripërtëritjeje:

I. Erjon Disani, i biri i Izet, shtetas Shqiptar, lindur me 14 Korrik 1991 ne Neshte, Librazhd, banues ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i kartes me nr personal J10714034Q, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar.

PJESA VI VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

Neni 19

Viti finanziar, pasqyrat vjetore financiare

19.1 Viti finanziar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë finanziar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.

19.2 Në fund të cdo viti finanziar, administratorët do të përbushin detyrat e mëposhtme:

- (a) përgatirjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
- (b) përgatirjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;

- (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 19.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm përmiratim.

Neni 20

Fitimi i Shoqërie

- 20.1 . Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.
- 20.2 . Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tativore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

PJESA VII PRISHJA DHE LIKUIDIMI


Neni 21 Prishja dhe likuidimi

- 21.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
 - (b) bashkimi me një shoqëri tjeter;
 - (c) vendimi i gjykatës me juridikcion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
 - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 21.2 Likuidimi i Shoqërisë dbe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

PJESA VIII TE PERGJITHSHME

Neni 22 Te pergjithshme

- 22.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiken t'i zgjidhin ato miqësish. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridikcion përkatës.



22.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.

22.3. Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (TRE) kopje originale.


Tirane me 08 Maj 2019


ORTAKET


Erjon Disani

Biljana Malevski

Lidjora Rrapo


Erjon Disani


Biljana Malevski


Lidjora Rrapo